

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PML.-KZZ, Nr. 261/2014
Prishtinë
21 maj 2015

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Willem Brouwer si kryetar i kolegjit, dhe Gjyqtari i Gjykatës Supreme Avdi Dinaj dhe Gjyqtari i EULEX-it Rolandus Bruin si anëtarë të kolegjit, në prani të Zyrtarit ligjor të EULEX-it Holger Engelmann, duke vepruar në cilësi të procesmbajtësit, në seancën e mbajtur më 21 maj 2015.

Në lëndën penale kundër të pandehurve:

1. E. K. me nofkën [redacted] emri i babait [redacted] i lindur më [redacted] në fshatin [redacted] Kosovë, me vendbanim në të njëjtin fshat, ka mbaruar shkollën e mesme, me gjendje të dobët ekonomike, shqiptar i Kosovës, në paraburgim prej 14 dhjetorit 2010 deri më 2 gusht 2011.
2. S. B. emri i babait [redacted] i lindur më [redacted] në fshatin [redacted] Kosovë, me vendbanim në Rahovec, [redacted] Kosovë, shqiptar i Kosovës, në paraburgim prej 18 prillit 2012 deri më 1 shkurt 2013;

Të dytë të akuzuar për kryerjen e veprës penale:

Krime të luftës kundër popullatës civile në bashkëkryerje në kundërshtim të neneve 142 dhe 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1976 (tani e tutje: KP RSFJ), aktualisht e dënueshme sipas neneve 31 dhe 153 paragrafëve 2.1 dhe 2.14 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës¹ (tani e tutje: KPRK), në lidhje me nenin 3 të konventës së katërt të Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe nenit 13.2 të Protokollit shtesë të Konventave të Gjenevës të 8 qershorit 1977 (Protokolli shtesë II).

Me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Supreme të Kosovës PA II. Nr. 3/2014, të datës 7 gusht 2014, të dënuar për veprën penale Krime të luftës kundër popullatës civile, siç është përshkruar më lart, dhe të dënuar me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) viteve.

Duke vendosur lidhur me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura më 11 dhjetor 2014 nga avokati mbrojtës E. K. në emër të pandehurit E. K. më 22 dhjetor 2014 nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës (ZPShK) dhe më 30 dhjetor 2014 nga avokati mbrojtës V. R. në emër të pandehurit S. B. kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PA II. Nr. 3/2014, të datës 7 gusht 2014, gjithashtu duke pasur parasysh përgjigjen e ZPShK-së ndaj kërkesave të të dy të pandehurve të paraqitura më 14 janar 2015.

Lëshon këtë:

¹ Ligji Nr. 04/L-082, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 19, 13 korrik 2012

AKTGJYKIM

Kërkesat për mbrojtje të ligjshme të paraqitura nga avokati mbrojtës në emër të pandehurit E. K. dhe nga avokati mbrojtës në emër të pandehurit S. B. dhe kërkesa për mbrojtje të ligjshme të paraqitur nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PA II. Nr. 3/2014, të datës 7 gusht 2014, REFUZOHEN SI TË PABAZUARA.

ARSYETIM

I. Historia e procedurës

- 1) Më 30 mars 2011, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK-ja) ka ngritur aktakuzën PPS. Nr. 75/2010 kundër të pandehurit E. K. dhe gjashtë (6) të bashkëpandehurve pranë Gjykatës së Qarkut në Prizren. E. K. është akuzuar për veprën penale Krime të luftës kundër popullatës civile në bashkëkryerje të kryer në fshatin Opterushë më 17 dhe 18 korrik 1998.
- 2) Më 29 prill 2011, aktakuza është konfirmuar me aktvendimin KA. Nr. 76/2011.
- 3) Gjykata e Qarkut në Prizren me aktvendimin KP. Nr. 170/2011, të datës 9 qershor 2011, ka refuzuar ankesën e të pandehurit kundër aktvendimit mbi konfirmim, si të pabazuar.
- 4) Më 28 qershor 2011, shqyrtimi gjyqësor ka filluar pranë Gjykatës së Qarkut në Prizren.
- 5) Me anë të aktgjykimit P. Nr. 134/2011 të datës 2 gusht 2011, Gjykata e Qarkut në Prizren ka shpallur fajtor të pandehurin E. K. për Krime të luftës kundër popullatës civile siç është përshkruar në akuzë (shih më lart) dhe e ka dënuar me pesë (5) vite burgim. Gjykata, përmes klauzolës së inkorporuar në dispozitivin e aktgjykimit të shpallur më 2 gusht 2011, ka ndërprerë paraburgimin kundër të pandehurit.
- 6) Më 13 shtator 2011, Gjykata Supreme e Kosovës ka refuzuar ankesën e paraqitur nga PSRK-ja kundër ndërprerjes së paraburgimit dhe ka vërtetuar atë pjesë të vendimit.
- 7) Më 18 prill 2012, i pandehuri S. B. është ekstraduar nga Shqipëria dhe pas shqyrtimit i është caktuar masa e paraburgimit.
- 8) Më 31 maj 2012, PSRK-ja ka ngritur aktakuzën PPS. Nr. 75/2010 kundër të pandehurit S. B. duke e akuzuar atë për veprën penale Krime të luftës kundër popullatës civile në bashkëkryerje të kryer në Opterushë më 17 dhe 18 korrik 1998.
- 9) Gjykata e Qarkut në Prizren me aktvendimin KA. Nr. 97/2012, të datës 27 qershor 2012, ka vërtetuar aktakuzën e lartpërmendur.

- 9) The District Court of Prizren with Ruling KA. No. 97/2012, dated 27 June 2012, confirmed the aforementioned Indictment.
- 10) On 4 September 2012 the Supreme Court of Kosovo granted appeals filed by the defendant E. K. [REDACTED] and another co-defendant against the District Court Judgment P. No. 134/2011, dated 2 August 2011, and annulled the convicting part of the Judgment, returning the case for re-trial.
- 11) With Ruling P. No. 249/12, dated 7 November 2012, the District Court of Prizren joined the proceedings against E. K. [REDACTED] and six (6) co-defendants with the ones against S. B. [REDACTED] under the case number P. 249/2012.
- 12) On 30 November 2012 the main trial commenced.
- 13) On 1 February 2013 the Basic Court of Prizren issued its Judgment P. No. 249/2012, acquitting all defendants. Detention on remand against S. B. [REDACTED] was terminated.
- 14) Upon an appeal filed by the Special Prosecutor on 28 May 2013, on 30 January 2014 the Court of Appeals issued Judgment PAKR. No. 271/2013, granting the SPRK Appeal and modifying the Judgment P. No. 249/2012 of the Basic Court of Prizren. The Court of Appeals found the defendants E. K. [REDACTED] and S. B. [REDACTED] guilty of the criminal offence of War Crimes against the Civilian Population in co-perpetration committed in the village of Opterushë/Opteraša on 17 and 18 July 1998. Each defendant was sentenced to a term of five (5) years of imprisonment. The other co-defendants were convicted for another criminal offence and sentenced to a suspended six months of imprisonment.
- 15) Upon appeals filed by the defendants, on 7 August 2014 the Supreme Court of Kosovo with Judgment PAII./KŽII. No. 3/2014 modified the Court of Appeals Judgment PAKR. No. 271/2013, dated 30 January 2014, sentencing E. K. [REDACTED] and S. B. [REDACTED] to two (2) years of imprisonment each, while acquitting the other co-defendants.
- 16) On 17 December 2014 Defence Counsel E. R. [REDACTED] on behalf of defendant E. K. [REDACTED] filed a Request for protection of legality against the aforementioned Supreme Court Judgment.
- 17) On 22 December 2014 the OSPK filed another Request for protection of legality in relation to the defendants E. K. [REDACTED] and S. B. [REDACTED].
- 18) On 30 December 2014 Defence Counsel V. R. [REDACTED] filed a Request for protection of legality on behalf of the defendant S. B. [REDACTED].
- 19) On 14 January 2015 the OSPK filed a Reply to the defendants' Requests.

II. Submissions of the Parties

1. Request filed by the OSPK

- 20) The OSPK bases its Request on substantial violations of the provisions of the criminal procedure and on violations of the criminal law.

- 21) Në veçanti, Gjykata Supreme ka tejkeluar autorizimet e saj të përcaktuara me ligj me rastin e ndryshimit të vendimit mbi dënimin. Fushëveprimi i shqyrtimit të gjykatës kufizohet në arsyet e ngritura në ankesat e të pandehurve të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR. Nr. 271/2013, të datës 30 janar 2014. Gjersa të dy ankesat e mbrojtjes kundërshtojnë dënimet “si tepër të ashpra” dhe “drakonike”, çështja e rrethanave lehtësuese nuk është ngritur nga asnjëri i pandehur. Rrjedhimisht, gjykata nuk ka qenë e autorizuar që sipas detyrës zyrtare të zbatojë nenin 42 paragrafin 2 të KP RSFJ-së dhe të zvogëlojë dënimet në minimumin e pesë (5) viteve burgim të përcaktuar me nenin 142 të KP RSFJ-së. Asnjëra nga shtatë (7) rrethanat të shqyrtuara nga Gjykata Supreme gjatë llogaritjes së dënimin nuk janë prezantuar me ankesat e mbrojtjes, asnjëra nga to nuk është zbutëse dhe asnjëra nga to nuk mund t’i atribuohet të pandehurve.
- 22) Në kërkesë i propozohet Gjykatës Supreme që të konstatojë se aktgjykimi PAII./KŽII. Nr. 3/2014, i datës 7 gusht 2014, është në shkelje të ligjit.

2. Kërkesa e paraqitur në emër të pandehurit E K

- 23) Avokati mbrojtës E R pohon se aktgjykimi i kundërshtuar përmban shkelje të ligjit penal (nenit 404 paragrafit 2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës² - tani e tutje: KPPK) dhe shkelje substanciale të nenit 403 paragrafit 1 pikës 12) të KPPK-së.
- 24) Dispozitivi është i pakuptueshëm, në mospërputhje me arsyetimin dhe aktgjykimit i mungojnë arsyet në lidhje me faktet vendimtare.
- 25) Në veçanti, në kërkesë pretendohet se aktgjykimi i kontestuar në arsyetimin e tij ka gjetur se të dy të pandehurit ndajnë qëllimin e grupit të UÇK-së për ta zhvendosur popullatën Serbe nga fshati dhe kanë dhënë kontributin e tyre individual për këtë qëllim. Në kundërshtim të kësaj, i pandehuri E K në dispozitiv është shpallur fajtor për frikësimin e popullatës.
- 26) Në kërkesë kundërshtohen gjetjet e aktgjykimit të kundërshtuar si: A mund të konsiderohet popullata e armatosur Serbe si civil? A janë të besueshme deklaratat e dhëna nga dëshmitaret D B dhe S B.
- 27) Aktgjykimi i kontestuar ka dështuar që të vërtetojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri K ka qenë i pranishëm në kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale. Gjithashtu ka dështuar që të sqaroj veprimet e të pandehurit, me të vilat ai ka kontribuar në kryerjen e veprës. As aktgjykimi nuk e shtjellon çështjen nëse grupi sulmues ka qenë i organizuar dhe nën komandën përgjegjëse dhe si i tillë a i nënshtrohet Konventave të Gjenevës.
- 28) Në kërkesë i propozohet gjykatës që të anulojë aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës PAII./KŽII. Nr. 3/2014 të 7 gushtit 2014, duke liruar të pandehurin E K nga përgjegjësia penale.

Kërkesa e paraqitur në emër të pandehurit S B

² I nxjerrë më 6 korrik 2003 me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/26, i riemëruar dhe ndryshuar më 6 nëntor 2008 me ligjin nr. 03/L.003

Request filed on behalf of defendant S [REDACTED] B [REDACTED]

- 29) Defence Counsel V [REDACTED] R [REDACTED] claims that the challenged Judgment contains substantial violations of Article 403 paragraph 1 item 12) of the KCCP since the enacting clause is incomprehensible, inconsistent with the grounds and the Judgment lacks grounds in relation to decisive facts.
- 30) The Request alleges the contested Judgment in its reasoning found that the defendant S [REDACTED] B [REDACTED] shared the purpose of the KLA group to displace the Serb population of the village and made their individual contributions to that purpose. In contradiction to that, the defendant in the enacting clause was found guilty for intimidating the population, which is a separate offence.
- 31) The witness D [REDACTED] B [REDACTED] testimony is not credible since it showed contradiction in regard to the clothing that S [REDACTED] B [REDACTED] allegedly wore and the arms he was allegedly carrying. Her husband was the mayor of the village and was carrying out the orders of the Serbian government and her son had joined the Yugoslav Army as volunteer. The testimony of the witness S [REDACTED] B [REDACTED] is not credible either since she was guided in her answers by the prosecutor.
- 32) The Request challenges that the Judgment does not meet the legally required standard of proof of beyond reasonable doubt.
- 33) The armed Serb population should not have been considered as civilians but as combatants. They had participated in acts of terror against the non-Serb population.
- 34) The Judgment fails to elaborate on the question if the assaulting group was organized and under responsible command and as such subject to international conventions.
- 35) The Request proposes to amend the contested Judgment and acquit S [REDACTED] B [REDACTED] from the charges, in accordance with the verdict P. No. 249/12 of the Basic Court of Prizren.

3. The Reply of the Office of the Chief State Prosecutor to the defence Requests

- 36) The Reply proposes to reject both defendants' Requests for protection of legality as unfounded.
- 37) The OSPK challenges that both defence Requests are erroneously based on the KCCP while the Criminal Procedure Code³ (henceforth: CPC) is applicable.
- 38) Neither of the defence Requests fulfil the formal legal requirements, as determined by Article 376 paragraph 1 subparagraphs 1.5., 1.7. and 1.8. of the CPC and therefore should not be considered.
- 39) The Requests are also without merit. They are unclear in respect to which judgment they contest: the final Judgment of the Supreme Court of Kosovo or the previous instance Judgment of the Court of Appeals, since only the latter establishes the guilt of the defendants.

³ Law No. 04/L-123, published in the Official Gazette of the Republic of Kosovo No. 37, 28 December 2012; in effect from 1 January 2013

- 40) Kërkesat e mbrojtjes i referohen shkeljeve të pretenduara të ligjit penal, sipas nenit 404 paragrafit 2 të KPPK-së, por dështojnë që të mbështesin pretendimin apo të ofrojnë ndonjë provë në mbështetje të tij.
- 41) Lidhur me argumentet plotësuese të paraqitura në kërkesat e mbrojtjes, ZPSHK-ja i cilëson ato vetëm si mosmarrëveshje me faktet e vërtetuara. Sidoqoftë, kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të bazohen mbi këtë bazë.

III. Gjetjet e Gjykatës Supreme

- 42) Kolegji gjen kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga ZPSHK-ja dhe në emër të të pandehurve E. K. dhe S. B., të pranueshme por të pabazuara.

I. Ligji i aplikueshëm

- 43) Në procedurën aktuale të mjetit të jashtëzakonshëm juridik ligji i aplikueshëm është KPPK-ja.
- 44) Sipas dispozitave kalimtare të nenit 545 paragrafit 1 fjalia 2 e KPP-së:

“Vendimi nëse duhet zbatuar këtë Kod të procedurës penale bazohet në datën e ngritjes së aktakuzës. Veprat të cilat janë kryer para hyrjes në fuqi të këtij Kodi i nënshtrohen këtij Kodi nëse procedura penale për hetimin apo ndjekjen e asaj vepre është filluar pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi”

- 45) Në *argumentum e contrario*, për aktet për të cilat këto kushte nuk vlejné, aplikohet kodi i procedurës penale i cili ka qenë në fuqi më parë. Prandaj, pasi që aktet e (akuzuara) kanë ndodhë para hyrjes në fuqi të KPP-së, hetimet kanë filluar më parë dhe aktakuza është ngritur më parë, është e qartë se KPPK-ja është e aplikueshme në këtë procedurë penale deri në marrjen e aktgjykimit të formës së prerë.
- 46) Ky interpretim i dispozitave kalimtare të KPP-së lidhur me të gjitha procedurat penale të cilat kanë filluar para hyrjes në fuqi të kodit të ri, për të cilat ka shqyrtimi gjyqësor ka filluar, por nuk ka përfunduar ose ka përfunduar mirëpo është kthyer në rigjykim përmes mjeteve të jashtëzakonshëm juridike, është konfirmuar me Mendimin juridik Nr. 56/2013, të miratuar nga Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 23 janar 2013.
- 47) Gjykata Supreme tani është dashur të vendos mbi çështjen nëse ky parim vlen për procedurat e mjeteve të jashtëzakonshme juridike, pasi që aktgjykimi është bërë i formës së prerë.
- Sipas sistemit të nenit 544 të KPP-së, i cili përcakton se:

“...Nëse pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi paraqitet ankesë ose me mjet të jashtëzakonshëm juridik anulohet aktgjykimi, shqyrtimi gjyqësor zbatohet përshtatshëm sipas dispozitave të kodit të mëparshëm”.

kolegji gjen se e njëjta vlen edhe për procedurën aktuale të mjetit të jashtëzakonshëm juridik e cila në mënyrë kronologjike ndodhë para rigjykimit. Prandaj, KPPK-ja vazhdon të jetë e aplikueshme deri në përfundimin e procedurës së mjetit të jashtëzakonshëm juridik, e cila bartë mundësinë që lënda të kthehet në rigjykim.

Kërkesa e paraqitur nga ZPShK-ja

- 48) Kolegji gjen se kundërshtimet e ngritura në kërkesën e ZPShK-së janë pa meritë. Gjykata Supreme në aktgjykimin e kundërshtuar nuk ka tejkalluar fushëveprimin e shqyrtimit e as autorizimin e saj të përcaktuar me ligj kur ka bërë zvogëlimin e dënimit për dy të pandehurit në dy (2) vjet burgim.
- 49) Fushëveprimi i shqyrtimit i Gjykatës Supreme mbi ankesat e mbrojtjes kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR. Nr. 271/2013 ishte përcaktuar në përputhje me nenin 415 paragrafin 1 të KPPK-së si pjesë e aktgjykimit i cili është kundërshtuar me ankesë dhe çështjet të cilat Gjykata është dashur t'i ekzaminojë *sipas detyrës zyrtare* (nën-paragrafët 1 deri 4).
- 50) Gjykata Supreme shënon se ankesat e të dy të pandehurve kanë kundërshtuar dënimet e shqiptuara si tepër të rënda. Prandaj gjykata e shkalës më të ulët ishte brenda fushëveprimit të përcaktuar me ligj kur ka bërë ekzaminimin e llogaritjes së dënimit.
- 51) ZPShK-ja pretendon se gjykata nuk ishte e autorizuar ta zbatojë dispozitën e nenit 42 paragrafit 2 të KP RSFJ-së. Kjo dispozitë është e ngjashëm në fjalëformim me nenin 66 paragrafin 2 të Kodit Penal të Kosovës⁴ (tash e tutje: KPK) dhe me nenin 75 nën-paragrafin 1.2. të KPRK-së. Kjo mundëson shqiptimin e dënimit nën kufirin e paraparë me ligj/statut kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana (në të dy kodet e reja) "posaçërisht lehtësuese" të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë.
- 52) Kolegji refuzon argumentin e paraqitur në kërkesën e ZPShK-së se gjykata e shkallës paraprake do të ishte e autorizuar vetëm për shqyrtimin e zbutjes së dënimit në përputhje me nenin 42 paragrafin 2 të KP RSFJ-së nëse me ankesë është kërkuar në mënyrë specifike një gjë e tillë ose të paktën nëse është ngritur çështja e rrethanave lehtësuese. Gjykata ka marrë parasysh nenin 42 paragrafin 2 të KP RSFJ-së duke u bazuar në argumentet e paraqitura në ankesa, e jo, siç pretendon ZPShK-ja *sipas detyrës zyrtare*.
- 53) Për të vlerësuar qëllimin e vërtetë të paraqitësve të ankesës Gjykata Supreme është dashur t'i interpretojë ankesat nga pikëpamja e aktgjykimit të kundërshtuar. Duke arritur në përfundim nga fakti se Gjykata e Apelit ka shqiptuar dënimin minimal me pesë (5) vjet burgim ndaj të dy të pandehurve⁵, ankesat e tyre për shqyrtim të dënimit do të ishin të pakuptimta nëse gjykata duhej të qëndronte brenda kufijve të paraparë me nenin 142 të KP RSFJ-së, pasi që brenda këtij kufiri nuk ishte i mundur zvogëlimi i mëtutjeshëm i dënimit. Prandaj interpretimi i vetëm i arsyeshëm i argumenteve të ankesës ishte që ato të

⁴ I nxjerrë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/25 më 6 korrik 2003 si 'Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës', më 6 nëntor 2008 i riemëruar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-002

⁵ Sa i përket të pandehurit [redacted] parimi i kufizimit të *reformatio in peius* parandalon dënimin më të rëndë pasi kur lënda ishte kthyer për rigjykim pas ankesës së avokatit mbrojtës, ankesa e prokurorit Special ishte hedhur poshtë si e palejueshme.

kuptohen si kërkesë për shqyrtimin e rrethanave posaçërisht lehtësuese, në përputhje me nenin 42 paragrafin 2 të KP RSFJ-së.

- 54) Sa i përket rrethanave posaçërisht lehtësuese të cilat gjykata i mori parasysh, kolegji shënon se nuk kërkohet që ankesat të emërojnë shprehimisht rrethanat posaçërisht lehtësuese të reja specifike. Pasi çështja e përgjithshme e rrethanave lehtësuese ishte ngritur nga të pandehurit, edhe në mungesë të paraqitjes së rrethanave të reja gjykata është dashur t'i ekzaminojë gjetjet faktike të instancave të mëparshme nëse kanë përmbajtur ndonjë kusht të tillë.
- 55) Kolegji shënon se nga shtatë (7) rrethanat e pretenduara specifike që ZPShK-ja i përmend si bazë për zbutjen e dënimit, dy të fundit:
- vi) Rrezikshmëria e veprës penale dhe kryerësit shumë më e ulët në krahasim me rastet e ngjashme,
 - dhe
 - vii) Koha e kaluar prej kryerjes së veprës penale;
- ishin përmendur vetëm në mbështetje të argumentit se nuk ekziston asnjë rrethanë rënduese në këtë lëndë.
- 56) Megjithatë gjykata pajtohet me argumentimin e ZPShK-së lidhur me rrethanat lehtësuese të renditura në kërkesë si i) dhe ii).
- 57) Nuk është vërtetuar si fakt nga asnjëra instancë e mëparshme se E. K. ka bërë thirrja nga jashtë shtëpisë për t'i mbajtur civilët brenda me qëllim të parandalimit të së keqes së panevojshëm. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit PAKR. Nr. 271/2013, i datës 30 janar 2014, në paragrafin 33 (faqet 10/11) konstaton se
- “Nga provat e prezantuara nuk ishte e mundur të vërtetohet saktë se çka kishte ndodhur gjatë sulmit ...”*
- 58) Për të dy të pandehurit ishte vërtetuar se kishin qenë të pranishëm në oborrin e Božanić-it menjëherë pas sulmit.
- 59) Në aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prizrenit P. Nr. 249/2012, të datës 1 shkurt 2013, në kapitullin VI. “Përmbledhje e Gjendjes së Vërtetuar Faktike” në faqe 12 nuk përmendet fare se E. K. ka thirrur banuesit të shtëpisë së Božanić-ëve para se të fillonin të shtënat.
- 60) Po ashtu sa i përket rrethanës së dytë të përmendur të mungesës së trajtimit mizor, çnjerëzor dhe degradues ose kërcënimeve, kolegji gjen se këto janë sjellje të pritshme dhe nuk konsiderohen si lehtësuese.
- 61) Megjithatë, gjykata merr parasysh rrethanat e tjera të përmendura se të palëve të dëmtuara u dhanë ushqim gjatë mbajtjes, se më vonë u ishin kthyer edhe paratë e marra dhe se ishin liruar pas një kohe të shkurtër, si rrethana valide lehtësuese për të pandehurit dhe si të përshtatshme për arsyetimin e lehtësimit të dënimit në përputhje me nenin 42 paragrafin 2 të KP RSFJ-së.

- 62) Kolegji refuzon kundërshtimin se rrethanat e përmendura nuk i atribuohen të pandehurve. Pasi në përputhje me nenin 22 të KP RSFJ-së të pandehurit janë shpallur penalisht përgjegjës për kryerje të përbashkët të veprës penale të Krimeve të luftës kundër popullsisë civile, mënyra dhe rrethanat e kryerjes së përbashkët të kësaj vepre duhet të llogariten në dëm dhe në dobi të secilit prej tyre. Detajet e përmendura lehtësuese ishin pjesë të dashjes (*mens rea*) së të pandehurve dhe me kontributin e tyre individual ata kanë kontribuar në planin e përbashkët.
- 63) Kolegji po ashtu pajtohet me vlerësimin e gjykatës së shkallës së mëparshme për pranimin e rrethanave posaçërisht lehtësuese dhe llogaritjen e dënimeve lehtësuese për të dy të pandehurit.

2. Kërkesat e paraqitura nga të pandehurit

- 64) Pasi argumentet në të dy kërkesat e mbrojtjes janë pothuajse identike gjykata nuk e sheh të domosdoshme që t'i shqyrtojë në kapituj të veçantë.
- 65) Të dy kërkesat si çështje të mjetit juridik e kanë aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës PAIL/KŽII. Nr. 3/2014 të datës 7 gusht 2014. Duke marrë parasysh se të dy kërkesat propozojnë lirimin e të pandehurit përkatës në pajtim me vendimin P. Nr. 249/12 të Gjykatës Themelore të Prizrenit, kolegji interpreton se qëllimi i kërkesave është kundërshtimi i aktgjykimit dënues të Gjykatës së Apelit PAKR. Nr. 271/2013, të datës 30 janar 2014, në formën e tij të prerë të aktgjykimit të sipërpërmendur të Gjykatës Supreme.
- 66) Gjykata Supreme gjen se është i pabazë pretendimi i mbrojtjes se ekziston kundërthënie në mes të dispozitivit, me të cilin të dy të pandehurit janë shpallur fajtorë për *frikësimin* e popullsisë, dhe të bazave që flasin për qëllimin e përbashkët të grupit të UÇK-së për *zhvendosjen* e popullsisë Serbe të fshatit Opterushë. Të dy aktgjykimet e kundërshtuara janë të qarta dhe të qëndrueshme në vlerësimin e sulmit të armatosur ndaj civilëve serbë si mënyrë të frikësimit të popullsisë me qëllim të shtrëngimit të tyre për tu larguar. Nuk ekziston asnjë kundërthënie në këto gjetje.
- 67) Sa i përket shkeljes së ligjit penal në përputhje me nenin 404 paragrafin 2 të KPPK-së, në të cilat pretendohet pa prova të mëtutjeshme në dy kërkesat e mbrojtjes, kolegji nuk sheh asnjë rrethanë që do të parandalonte përgjegjësinë penale.
- 68) Në përputhje me nenin 451 paragrafin 2 të KPPK-së, argumentet e mbrojtjes për mungesën e standardit të provave, dyshimet e pretenduara të besueshmërisë së dëshmitarëve, dyshimi i pretenduar për statusin civil të personave subjekt i sulmit të armatosur dhe statusin dhe shkallën e organizimit dhe komandës së grupit të armatosur janë pretendime për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe si të tilla nuk lejohen.
- 69) Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës në lidhje me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë vendosi si në dispozitiv.

Kryetari i kolegjit:

Willem Brouwer
Gjyqtar i EULEX-it

Anëtarët e kolegjit:

Avdi Dinaj
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Rolandus Bruin
Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtës:

Holger Engelmann
Zyrtar ligjor i EULEX-it

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PML.-KZZ. Nr. 261/2014
Prishtinë
21 maj 2015



Republika e Kosovës  Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TËCHNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlaščeni radnik